



Datë: 12.02.2026

Numër Protokolli: 786/2026

A.nr.2097/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.2097/2025, të datës 31.12.2025, të parashtruar nga ankuesja L.M.S, nga Prishtina, kundër organit të punësimi/Thesari të Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, s i dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 12.02.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa A.nr.2097/2025, e datës 31.12.2025, e parashtruar nga ankuesja L.M.S.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, L.M.S (*në tekstin e mëtejme referuar: ankuesja*), me datë 31.12.2025, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.2097/2025, kundër Vendimit Nr.57/2025 të datës 21.11.2025 të UD/Drejtorit të Thesarit të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 15.01.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Thesari i Kosovës, ndërsa kjo e fundit, me datë 20.01.2026, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 8152/2025 e parashtruar nga ankuesja më datën 31.12.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen Nr.506 të datës 02.12.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Thesarit të Kosovës; Shkresën e datës 25.11.2025 të ankueses; Vendimin e datës 21.11.2025 të UD/Drejtorit të Thesarit të Kosovës; Kërkesa e datës 07.11.2016; Akt Emërimit e datës 15.12.2016; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i lartë ekzekutiv të datës 19.12.2016; Akt Emërimit e datës 01.08.2013; Kërkesa e datës 07.03.2023 me tabelën e bashkangjitur; Listë pagash e muajit maj 2020; Kopja e ID-së së ankueses; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 15.01.2026; Përgjigje në ankesë e datës 20.01.2026; Organogrami apo struktura organizative e Thesarit të Kosovës; Memorandumi i datës 14.01.2015; Akt Emërimit e datës 28.03.2012; E-mailin e datës 21.11.2025; Shkresë e datës 23.01.2024; Vendimin e datës 05.08.2013; Kërkesë e datës 02.08.2013; Konkursin e datës 16.11.2016; Diplomë e datës 22.01.2015; E-mailin e datës 02.12.2025; Parashtesa Nr.10799 e datës 02.12.2025 nga ankuesja.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e *palejuar*, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesja sipas Aktit të Emërimit të datës 19.12.2016 mban pozitën e punës “Zyrtare e Lartë Ekzekutive” në Thesarin e Kosovës, ndërsa e njëjta me datë 25.11.2025 kishte parashtruar shkresë kundërshtuese me përmbajtje të pretendimeve ankimore kundër Vendimit Nr.57/2025 të datës 21.11.2025 të UD/Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës, kurse nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me datë 02.12.2025 ankueses i ishte kthyer një përgjigje sqaruese lidhur vendimmarrjen e datës 21.11.2025 të UD/Drejtorit të Përgjithshëm Thesarit të Kosovës.

Ankuesja në ankesën e parashtruar kundër Vendimit Nr.57/2025 të datës 21.11.2025 të UD/Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës, pretendon se i janë cenuar të drejtat që burojnë nga marrëdhënia e punës, të drejta këto të fituara pas pensionimit të Koordinatorit të Kabinetit përmes procedurave rekrutuese, me arsyetimin se detyrat e deleguara janë në kundërshtim me Organogramin, raportet hierarkike dhe detyrat e secilës pozitë, me theksin se pozita e koordinatorit në Thesar ka qenë duke u ushtruar në mënyrë të pandërprerë, sikurse akti i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me Rregulloren Nr.06/2014 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Thesarin e Kosovës.

Fillimisht, Kolegji i Këshillit thekson faktin se nga shkresat e administruara të lëndës, të ofruara nga organi i punësimit, gjegjësisht Thesari i Kosovës, është konstatuar fakti se ankuesja pasi që e kishte kundërshtuar fillimisht aktin e kontestuar me datë 25.11.2025 te organi që e ka nxjerrë të njëjtën, e njëjta me datë 02.12.2025 po ashtu i ishte drejtuar me shkresë UD/Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës përmes së cilës deklaronte se tërhiqej nga ankesa e saj apo kundërshtimi i shprehur përmes shkresës së datës 25.11.2025 lidhur me vendimmarrjen sipas vendimit të datës 21.11.2025, mirëpo këtë fakt e njëjta nuk e ka potencuar edhe në ankesën e parashtruar në Këshill.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit mori për bazë dhe iu referua nenit 5 paragraf 1 të Rregullores Nr.06/2014 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Thesarin e Kosovës ku përcaktohet se: “1. Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit përbëhet nga: 1.1. Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit; 1.2. Koordinator i Zyrës së Drejtorit; 1.3. Asistentja ekzekutive e Zyrës së Drejtorit; 1.4. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit janë: 1.4.1. I raporton Ministrit të Financave sipas kërkesave të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe ligjeve tjera të zbatueshme; 1.4.2. Ushtrimi i kontrollit dhe përgjegjësisë mbi zhvillimin dhe mirëmbajtjen e SIMFK-së dhe funksionin e TI-së; 1.4.3. Menaxhimi i fondeve të donatorëve; 1.4.4. Menaxhimi i ekzekutimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës në harmoni me ligjin, rregullat dhe procedurat në fuqi; 1.4.5. Menaxhimi i llogarive bankare të Fondit të Republikës së Kosovës; 1.4.6. Alokimet e fondeve në pajtim me Ligjin e buxhetit të Republikës së Kosovës; 1.4.7. Barazimi i llogarive dhe raportimi financiar sipas kërkesave të LMFP-së; 1.4.8. Menaxhimi i borxhit publik të Republikës së Kosovës; 1.4.9. Shpallja e ankandëve për emetim të letrave me vlerë dhe aprovimin e rezultatit; 1.4.10. Drejtori i Përgjithshëm miraton procedurat për zbatimin e kontrollit të brendshëm në Thesar”, ndërlidhur me nenin 10 të Ligjit NR. 03/L-048 Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ku përcaktohet se: “10.1 Zyrtari Kryesor Administrativ ka përgjegjësinë kryesore ligjore për të siguruar që organizata buxhetore, agjencia autonome ekzekutive ose ndërmarrja publike dhe personeli i saj të jenë në përputhshmëri të plotë si dhe të respektojnë dispozitat e zbatueshme të këtij ligji dhe Rregullat KMF. 10.2 Zyrtari Kryesor Administrativ, ndër tjera, është shprehimisht përgjegjës për: a) vendosjen e kontrollit të brendshëm në organizatën buxhetore, agjencinë autonome ekzekutive ose ndërmarrjen publike sipas Rregullave KMF; b) delegimin e funksioneve për mbledhjen dhe shpenzimin e parave publike në pajtim me Rregullave KMF; c) vendosjen e një kornize për vlerësimin dhe menaxhimin e performancës së personelit të organizatës buxhetore të cilëve u janë deleguar funksionet e tilla; d) vendosjen dhe zbatimin e masave të brendshme disiplinore për tu zbatuar në raste kur personeli nuk i ushtron funksionet e deleguara në mënyrë adekuate apo të rregullt; dhe e) njoftimin e Auditorit të Përgjithshëm për të gjitha rastet ku me arsye dyshohet se ka pasur shkelje – nga një person ose ndërmarrje – të këtij ligji, Rregullave KMF ose ndonjë ligji tjetër”, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se UD/Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës, se Vendimin Nr.57/2025 të datës 21.11.2025 përmes të cilit një nëpunës civil të kategorisë së ulët drejtuese e kishte ngarkuar me detyra dhe përgjegjësi shtesë të karakterit koordinues, krejt kjo që ky i fundit respektivisht UD/Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të përmbushte autorizimet dhe përgjegjësitë ligjore me qëllim të ushtrimit efikas dhe përmbushjes së funksionit të vetë Institucionit përkatësisht Thesarit të Kosovës.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit konstatoi se Thesari i Kosovës, sipas organogramit ka të përcaktuar edhe strukturën organizative të vetë Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm, ashtu që në kuadër të këtij Organogrami ishte përcaktuar edhe pozita Koordinator i Zyrës së Drejtorit, pozitë kjo e cila nuk ka titullar, respektivisht sipas organogramit në fjalë apo dispozitave të rregullores të cilës ankuesja i referohet, nuk është e përcaktuar askund që këto përgjegjësi i takojnë pozitës “Zyrtare e Lartë Ekzekutive” të cilën ankuesja e mban sipas aktit të emërimit të datës 15.12.2016, ndërsa mbetet në përgjegjësi të Thesarit të Kosovës që në të ardhmen me rastin e hartimit të aktit të ri për organizmin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, të përcaktoj qartë detyrat dhe përgjegjësitë e secilës pozitë, sikurse të përcaktoj edhe kategorinë dhe klasën përkatëse sipas kuadrit ligjor në fuqi të ligjit material për shërbimin civil.

Thënë si më lartë, pas konstatimit të dhënë si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit para se të lëshohet në shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses, analizoi dispozitat që trajtojnë çështjen e pranueshmërisë së ankesës në parim, andaj u morën për bazë neni 129 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 i Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “**1. Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji; 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji; 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji, dhe 1.4. çfarëdo kushte të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj**”, dhe konstatoi se ankesa e ankueses në rrethanat e rastit konkret është e papranueshme respektivisht është e palejuar pasi që ankuesja nuk e ka legjitimitetin e palës në procedurë sipas përcaktimeve nga neni 124 i të njëjtit ligj, pasi që me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.57/2025 të datës 21.11.2025 të UD/Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës, nuk është arritur të konstatohet se të njëjtës i janë cenuar të drejtat nga marrëdhënia e punës sikurse e njëjta pretendon, respektivisht e njëjta nuk ka arritur të argumentoj me asnjë provë pretendimin e saj si në ankesën e saj të datës 31.12.2025, andaj edhe është hedhur poshtë si e pa lejuar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.2097/2025, datë 12/02/2026.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses L.M.S;
- Thesarit të Kosovës (UD/Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.